



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Sk.II.nr.1213/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit T...Shpk me seli në fshatin, Komuna e Suharekës, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.306/2020 të datës 11.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.10.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë e ushtruar me datën 20.01.2022, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.306/2020 të datës 11.11.2021, Vërtetohet.

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.306/20, të datës 11.11.2021, është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit T...Shpk me seli në fshatin, Komuna e Suharekës, në pikën II të dispozitivit është anuluar aktvendimi nr. 01.3.2.2/1519, 15411 i datës 10.12.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, në pikën III, obligohet e paditura Dogana e Kosovës që paditësin T...Shpk me seli në fshatin, Komuna e Suharekës, ta liroj nga pagesa e gjobës në shumën prej 1,800.00€ e vendosur në emër të kundërvajtjes doganore sipas aktvendimit 03.1.7-2019-1554/2 të datës 22.10.2019, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Në pikën IV, ky aktgjykim e zëvendëson aktvendimin nr. 01.3.2.2/15195, 15411 të datës 10.12.2019 të Doganës së Kosovës në Prishtinë. Në pikën V të dispozitivit, secila palë ndërgjyqëse i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe

zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, prishet Aktgjykimi A.nr.306/2020 të datës 11.11.2021, ta refuzon padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me ligj dhe të lë në fuqi aktvendimin e kontestuar, ose t'ia kthej gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje. E paditura gjatë inicimit të procedurës kundervajtëse është thirr në Mendimin për klasifikim tarifor 04.1.2nr.59/30.06.2019 i cili mendim ishte lëshuar ndaj të njëjtit subjekt për mallin identik. Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore janë se në arsyetim të aktgjykimit nuk janë theksuar faktet vendimtare dhe se gjykata e shkallës së parë nuk ka administruar drejt provat ngase paditësi disa herë ishte shpallur fajtor dhe gjobitur nga e paditura.

Në përgjigjen në ankesë i autorizuari i paditësit deklaroi se ankesa e të paditurës është në tersi e pabazuar. Gjykata me të drejtë konstaton se një formë e tillë e ndryshimit të kodit tarifor nga e paditurës është e papranueshme pasi që e paditura nuk ka kontestuar fare dokumentacionin përcjellës e në veçanti BTI 2019-0360M-13810, në të cilën deklaratë është shkruar edhe kodi tarifor i njëjtë sikurse ai i deklaruar nga paditësi për mallin 84388010. I propozojmë gjykatës së Apelit të marr aktgjykim me të cilin refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet aktgjykimi i atakuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/15195,15411 i datës 10.12.2019, e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e subjektit në procedurë N.T.P. T...me seli në Suharekë, për rishqyrtimin e vendimit nr. 03.1.7-2019-1554/2 i datës 22.10.2019 të Sektorit për Kundërvajtje Doganore, si e pa bazuar.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi në gjykatë, me të cilën ka inicuar konflikt administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, respektivisht me padi është kundërshtuar vendimi përfundimtar në procedurë administrative nr.01.3.2.2/15195,15411 i datës 10.12.2019, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke anuluar vendimin lartcekur të paditurës, si dhe duke obliguar të paditurën Dogana e Kosovës, në Prishtinë, që paditësin T...Shpk me seli në fshatin, Komuna e Suharekës, ta liroj nga pagesa e gjobës në shumën prej 1,800.00€ e vendosur në emër të kundërvajtjes doganore sipas aktvendimit 03.1.7-2019-1554/2 të datës 22.10.2019, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Në arsyetim të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, ka jep konstatimin se e paditura pa bazë ligjore dhe në kundërshtim me provat në dispozicion e ka ndryshuar kodin tarifor për mallin e deklaruar nga paditësi përmes DUD-it R-

.../19.10.2019 me kodin 8438801000, në bazë të cilit kod malli lëndor mullinj elektrik industrial jo shtëpiak për bluarjen e kafesë, për aparatet e kafes ekspreso, lirohet nga taksa doganore, bazuar në Ligjin 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor, në kodin tarifor 8509400000 të ndryshuar nga e paditura sipas të cilit kod për mallin lëndor duhet paguar taksa doganore prej 2%. Mënyra e ndryshimit të kodit tarifor për gjykatën është e papranueshme sepse e paditura nuk e ka kontesuar fare validitetin e dokumentacionit përcjellës të mallit nga paditësi, ku përfshihet informata e detyrueshme tarifore BTI 2019-0360M-138100 e lëshuar nga Unioni Evropian-Agjencia e Doganave dhe Monopoleve-Drejtoria e Doganave në Itali, ku është numri tarifor i deklaruar nga paditësi për mallin lëndor me kodin tarifor 84388010. E paditura nuk ka kërkuar dokumente tjera nga paditësi për të verifikuar saktësinë e të dhënave në deklaratën doganore siq parashihet me nenin 72 par.1 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109 dhe as nuk ka marr mostrat e mallit që parashihet me nenin 265 të këtij Kodi. Nga një gjendje e tillë faktike rezulton se akti administrativ kontestues i të paditurës duhet të anulohet për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrativ, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga fakti se në arsyetim të aktgjykimit nuk i ka theksuar faktet vendimtare, Kolegji, vlerësoi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Aktgjykimi i ankimuar nuk përbën shkelje esenciale, pasi që Kolegji vlerësoi se në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar më të drejt janë dhënë faktet vendimtare që kanë ndikuar në anulimin e vendimit administrativ kontestues, dhe vendimin për shqiptimin e gjobës administrative ndaj paditësit, për shkak të kryerjes së kundërvajtjes doganore nga neni 276 paragrafi (k) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi se gjykata e shkallës së parë, ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPK-së. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, këtë pretendim e Kolegji, e refuzon si të pa bazuar. Në rastin konkret kjo gjykatë, nga shkresat e lëndës, konstatoi se me të drejt janë vlerësuar si dokumentacione të mjaftueshme dhe valide dokumente që ka paraqit paditësi para të paditurës kur ka deklaruar mallin lëndor me kod tarifor 8438801000 që lirohet 2% nga obligimet doganore, gjithnjë duke marrë për bazë BTI 2019-

0360M-138100 e lëshuar nga Unioni Evropian-Agjencia e Doganave dhe Monopoleve-Drejtoria e Doganave në Itali, të cilin dokument të lëshuar nga shteti dërgues eksportues, që dëshmon kodin e sakt tarifor, e paditura nuk arrin ta kontestoj apo të provoj të konfirmoj vërtetësin e tij nga autoritetet e shtetit eksportues Itali. Në këtë rast e paditura para gjykatës është dashur që me prova bindëse të dëshmoj se paditësi ka bërë deklaram të pa saktë të kodit tarifor të mallit, po ashtu e paditura nuk ka kërkuar dokumente të tjera nga paditësi për të verifikuar saktësinë e të dhënave në deklaratën unike doganore.

Kolegji i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë, e cila në këtë rast ka marrë për bazë dokumentacionet përcjellëse të mallit lëndor dhe Informatën e detyrueshme tarifore IT BTI 2019-0360M-138100 të lëshuar nga shteti eksportues Italia nga ku shihet se malli “dozues për kafe, produkti që përdoret në bare dhe në restorante për bluarjen dhe përgatitjen e kafes”, përfshihet në numrin tarifor 84388010 ashtu siç është deklaruar nga paditësi me rastin e paraqitjes së mallit për zhdoganim tek e paditura, andaj Kolegji, kostaton se nuk janë përmbushur kriteret ligjore për tu kualifikuar veprimi i palës paditëse si kryerje e kundërvajtjes doganore nga neni 276 paragrafi (k) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109. Kjo gjendje faktike e dokumentacionit të mallit lëndor të deklaruar me DUD-in R.../19.10.2019 e bën të pranueshme konstatimin e gjykatës së shkallës së parë se e paditura nuk ka bërë një vlerësim të drejtë me rastin e ndryshimit të kodit tarifor për mallin lëndor kontestues kur përmes Mendimit tarifor të Sektoit të Tarifës nr.04.1.2 nr.59/03.06.2019, ka ndryshuar kodin tarifor në mënyrë të gabuar.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Sk.II.nr.1213/22 datë 13.10.2022

Kryetar i kolegjit,

